

**Data 20.04.2023
Ora 15:19**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”

PJESËMARRJA:

KQZ:

- **Komisioni Rregullator:**

- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y. Merkaj, V. Ballgjini, E. Meta**
- **OJQ: KRIIK, ODIHR**

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së, përfaqësues të misionit të vëzhgimit të ODIHR-it, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Në mbledhjen e sotme në rendin e ditës kemi tre projektvendime për shqyrtim e miratim: “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”, “Për një shtesë në udhëzimin nr. 1,



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të ndryshuar dhe “Për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionet e Qendrave të Votimit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”. Para se të fillojmë me shqyrtimin sipas rendit, do të pyesja kolegët nëse kanë diçka jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Kolegë? Zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Në lidhje me administratën, një detyrë dhe kaq.

Znj. I. Nano: Zoti Çakaj.

Z. M. Cakaj: Po edhe unë kisha diçka jashtë rendit të ditës. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Do të fillojmë me shqyrtimin e çështjeve që kemi në rendin e ditës, më pas do ta marrin fjalën sipas radhës zonja Vukaj dhe zoti Çakaj. Fillojmë me projektvendimin e parë “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Pak ditë më parë Komisioni Rregullator ka miratuar rregullat e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Sot kemi për shqyrtim miratimin e udhëzuesve, pra mënyrës sesi do të përpilohen raportet, të cilat dorëzohen në KQZ, për shpenzimet dhe të ardhurat gjatë fushatës zgjedhore. Do ta prezantojë Sekretari i Përgjithshëm? Zoti Merkaj.

Z. Y. Merkaj: Neni 20, pika 1, shkronja “gj” e Kodit Zgjedhor parashikon kompetencën e Komisionit Rregullator për të miratuar projektakte me karakter normativ për udhëzuesit dhe doracakët në shërbim të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve. Në zbatim të dispozitës së mësipërme,

*Zbardhi materialin audio
Atma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

referuar edhe vendimit nr. 15, datë 07.04.2023, të Komisionit Rregullator, i cili ka miratuar rregullat për raportimin financiar të partive politike/subjekteve zgjedhore, është hartuar projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Projektvendimi ka për qëllim përcaktimin e një përmbledhjeje të bazës ligjore dhe kërkesave që rregullojnë financimin e fushatës zgjedhore për partitë politike/subjektet zgjedhore, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, si dhe jep udhëzime për mënyrën e plotësimit të formularit tip të raportimit të financimit të fushatës zgjedhore nga partitë politike, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Projektvendimi nëpërmjet shembujve konkretë pasqyron mënyrën e saktë të plotësimit të formularëve tip të raportimit financiar të fushatës zgjedhore. Udhëzuesit bashkëlidhur këtij projektvendimi synojnë të shpjegojnë aspektet kryesore të kuadrit ligjor dhe në veçanti të ndihmojnë partitë politike, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për mënyrën e plotësimit të raporteve financiare të fushatës zgjedhore, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Në funksion të këtij qëllimi, janë përgatitur 4 udhëzues përkatësisht: udhëzuesi për raportimin e partive politike; udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët e listave shumemërore; udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët për kryetar bashkie; udhëzues për mënyrën e raportimit financiar për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit. Udhëzuesit janë të ndarë në dy pjesë kryesore: Pjesa e parë paraqet një pasqyrë të kuadrit ligjor që rregullon aspektet e financimit të fushatave zgjedhore dhe pjesa e dytë ofron udhëzime për mënyrën e plotësimit të formateve të raportimit financiar.

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

Pjesë përbërëse e këtyre udhëzuesve janë të gjitha shpjegimet e nevojshme që kanë të bëjnë me seksionet kryesore të formatit tip të raportimit. Bashkëlidhur është projektvendimi për shqyrtim dhe miratim, si dhe udhëzuesit përkatës. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Merkaj! Kolegë, fillojmë shqyrtimin. Në fakt, është një projektvendim voluminoz, sepse kemi të bëjë me katër udhëzues, të cilët përveç bazës ligjore për secilin prej subjekteve raportuese për fushatën zgjedhore janë të shoqëruar edhe me shembuj, të cilët u mundësojnë një kuptim më të mirë zbatuesve të këtij akti për të realizuar në mënyrë korrekte raportimin financiar të fushatës zgjedhore. Në parim, kolegë, diçka për aktin? Jo. Kalojmë në miratimin në parim të projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen apo pikë për pikë. “Komisioni Rregullatori vendosi: 1. Miratimin e udhëzuesve për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike kur konkurrojnë më vete apo si pjesë e një koalicioni, kandidatët për kryetar bashkie, kandidatët e listave shumemërore, si dhe kandidatët e propozuar nga zgjedhësit për fushatën zgjedhore për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, si vijon: a) udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike/koalicionet, sipas modelit KQZ 07-06, shtojca nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi; b) udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e listave shumemërore, sipas modelit KQZ 07-07, shtojca nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi; c) udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët për kryetar

**Zbardhi materialin audio
Alma KOLA**



bashkie, sipas modelit KQZ 07-08, shtojca nr. 3 bashkëlidhur këtij vendimi; d) udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, sipas modelit KQZ 07-09, shtojca nr. 4 bashkëlidhur këtij vendimi.”. Në fakt, kjo është pika 1 e këtij projektvendimi, e cila ka katër shtojcat që përmbajnë katër udhëzuesit. Kolegë, keni diçka, apo do të kërkonit diçka nga drejtoria përkatëse që ka përpunuar projektvendimi? Nëse është e mundur, zonja Ballgjini, dy fjalë për secilin nga udhëzuesit, duke e pasur parasysh që në total bëhet fjalë për të gjitha kategoritë e subjekteve që kanë detyrimin për raportimin financiar gjatë fushatës, por edhe ndarjen, risitë e këtij projektvendimi.

Znj. V. Ballgjini: Sikurse u citua edhe pak më parë, në mbledhjen e mëparshme të Komisionit Rregullator u miratuan rregullat për raportimin financiar të partive politike, kandidatëve të listave shumemërore dhe kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit. Risi edhe në vendimin e parë ishte edhe bërja pjesë e raportimit financiar të partive politike apo edhe të koalicioneve sesi do të trajtohet dhe kush do ta mbajë përgjegjësinë në rastin e raportimit financiar. E njëjta gjë është trajtuar edhe në udhëzuesit e raportimit financiar për fushatën zgjedhore për organet e qeverisjes vendore. Shtojca e parë e këtij udhëzimi ka të bëjë me mënyrën e plotësimit dhe me shembuj konkretë për të ndihmuar partitë politike, financierët e partive politike për të përmbushur detyrimin e tyre lidhur me raportimin financiar të fushatës zgjedhore në KQZ. Gjithashtu, shtojca e dytë që i bashkëlidhet këtij vendimi ka të bëjë me mënyrën sesi kandidatët e listave shumemërore të partive politike duhet të plotësojnë raportin financiar e më pas për t’ua dërguar financierëve të partive politike. Shtojca nr. 3 ka të bëjë me kandidatët për kryetar bashkie, të cilët trajtohen më vete edhe në detyrimin e raportimit financiar si pjesë më vete e raportimit, nuk hyjnë në listat e kandidatëve të listave shumemërore, por trajtohen në një model më vete. I fundit është udhëzuesi për kandidatët e propozuar nga zgjedhësit, për të cilët edhe në aktin e

parë, siç e kemi diskutuar, patëm disa ndryshime në detyrimet e kandidatëve të propozuar nga zgjedhësit për të mos pasur financierë të tyre. Nuk ua heqim si të drejtë. Nëse ata duan të kenë financierë, mund t'i marrin, por nuk e kanë detyrim ligjor pasjen e një financieri për të dorëzuar pasqyrat financiare në KQZ.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Unë kam diçka të vogël në variantin e printuar për secilin udhëzues para se të vijmë te formati, janë pjesa narrative që nga baza ligjore, që nga shembujt e ofruar nga ana juaj. Në krye të faqes në secilën nga këto është printuar modeli. Në fakt, nuk është ky modeli. Modeli vjen më pas, është një format i miratuar në formatin *excel*. Për udhëzuesin e parë fillon në faqen 16 me përmbledhjen financiare e me radhë. Kështu që gjatë zbardhjes, mendoj që prej aty të fillojë ku është modeli.

Z. D. Çaka: Duke qenë se e njëjta gjë është reflektuar edhe në pikën 1 të projektvendimit të sjellë, unë kam një pyetje: modelet KQZ 07-06 e në vazhdim deri në 09 janë modele nëpërmjet të cilave është miratuar udhëzuesi apo tabelat që i janë bashkëngjitur këtij udhëzuesi? Në pikën 1, shkronja “a”, të projektvendimit thuhet “udhëzues për mënyrën e raportimit financiar nga partitë politike/koalicionet, sipas modelit, shtojca nr.1...” dhe e njëjta gjë është reflektuar edhe tek udhëzuesi ku në krye është vendosur “Model KQZ 07-06” e në vazhdim. Kjo gjë mos duhet reflektuar edhe në draftin e vendimit? Ne po miratojmë një udhëzues.

Znj. I. Nano: Me çfarë akti dhe si janë miratuar këto modele?

Znj. V. Ballgjini: Ky numër që u është vendosur këtyre modele në këtë akt, nuk kanë lidhje me aktin e parë, pra nuk janë modele, të cilat i referohen aktit të parë,

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

janë modele të tjera, është një vendim i Komisionerit që çdo dokument apo udhëzues që miratohet të marrë një numër kodifikimi.

Znj. I. Nano: Formate ka miratuar Komisioneri?

Znj. V. Ballgjini: I ka ndarë në kategori.

Znj. I. Nano: Pra, ky modeli KQZ 07-06 është një format, apo thjesht është një emër që i përket një udhëzuesi?

Znj. V. Ballgjini: Është emër që i përket një udhëzuesi, sepse janë të ndryshme.
(Diskutime pa mikrofon)

Pra, 07-ta lidhet me udhëzuesit, pastaj numri i dytë që merr varet nga modelet, nga udhëzuesit për secilën drejtori, pra secila drejtori ka emërtesa të ndryshme.

Znj. I. Nano: Për mua është e qartë pas shpjegimit. Atëherë, kalojmë në votimin e pikës 1 të projektvendimit, kolegë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

“Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare elektronike të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për zbatimin e këtij akti.” Personalisht do të isha për ta ndarë këtë në dy pika, ngarkimin e administratës dhe hyrjen në fuqi. Votojmë përmbajtjen dhe pastaj ndarjen e bën administrata.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

“Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.”

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektaktit, pasi e kemi miratuar në parim dhe nen për nen.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Vendimi nr. 20

*Zbardhi materialin audio
Alma KOLA*



RENDI I DITËS

2.Projektvendimi “Për një shtesë në Udhëzimin nr. 1, datë 5.12.2020 të Komisionit Rregullator “ Për përcaktimin e rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, i ndryshuar”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y. Merkaj, M. Koja, V. Ballgjini, E. Meta, A. Tahiraj
- Parti Politike: PDIU, PL
- OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, kemi një shtesë në udhëzimin nr. 1 datë 05.12.2020 të Komisionit Rregullator “Për përcaktimin e rregullave për ngritjen caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

zgjedhjet”, i ndryshuar. Me sa shihet është një ndryshim që lidhet me një shtojcë të re. Sekretari i Përgjithshëm ose drejtori përkatës, keni fjalën.

Z. Y Merkaj: Komisioni Rregullator në udhëzimin numër 1, datë 05.12.2020, ka përcaktuar rregullat për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së Qendrave të Votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet, siç është ndryshuar më vonë. Në nenin 5 të këtij udhëzimi janë përcaktuar kriteret teknike dhe pajisjet që duhet të ketë qendra e votimit ku, ndër të tjera, parashikohet dhe marrja e masave për të pajisur qendrën e votimit me pajisje sipas skemës tip të planvendosjes. Kjo skemë siç është miratuar në këtë udhëzim lidhet me procesin e zgjedhjeve për Kuvendin dhe nuk është parashikuar një skemë tip e planvendosjes për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Duke qenë se në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore votohet me dy kuti votimi, një për kryetarin dhe një për këshillin e bashkisë diktohet nevoja për paraqitjen e një skeme tip për planvendosjeje për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtimin dhe miratimin si dhe skemën tip të planvendosjes për qendrën e votimit më të dy kutitë e votimit. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Merkaj. Është e kuptueshme që është një ndryshim i vogël, por i rëndësishëm, për shkak se kur është miratuar ky udhëzues para ishin zgjedhjet për Kuvendin. Vërtetë zgjedhjet e vitit të kaluar ishin për organet e qeverisjes vendore, por vetëm për kryetarin, kështu që tashmë jemi para zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore ku do të votohet dhe për kryetarët e bashkive, dhe për anëtarët e këshillave, kështu që, sipas Kodit Zgjedhor, duhet të jenë dy kuti votimi. Unë, ndërkohë që po e shqyrtoj, do të doja ta ekspozoja para kamerës. Nuk është shumë e dukshme, por gjithsesi kjo është skema ku kemi

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

dy kutitë e votimit. Atëherë, kolegë kalojmë në shqyrtimin në parim. A keni ndonjë mendim lidhur me projektaktin? Jo. Votojmë në parim projektaktin.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen. Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Komisioni Rregullator vendosi: 1. Në udhëzimin numër 1, datë 05.12.2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar , bëhet shtesa si më poshtë vijon: a. Në fund të shkronjës “a”, të pikës 3 të nenit 5 shtohet fjalia si vijon: Të njëjtat masa merren edhe për zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore sipas skemës tip të planvendosjes bashkëlidhur këtij udhëzimi”.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohen në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

Kalojmë në votimin në tërësi të projektaktit.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Faleminderit!

Vendimi nr. 21

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



Data 20.04.2023
Ora 15:39

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionet e Qendrave të Votimit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana NANO Kryetar
- Arens ÇELA Anëtar
- Dritan ÇAKA Anëtar
- Helga VUKAJ Anëtar
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar
- Stafi KQZ Y. Merkaj, V.Ballgjini, E. Metaj, A.Tahiraj
- Parti Politike: PDIU, PL
- OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës “Projektvendim për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionet e Qendrave të Votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Edhe ky është një akt shumë i rëndësishëm që vjen pikërisht në kohën kur po formohen komisionet e qendrave të votimit dhe do t’iu vihet në dispozicion ky udhëzues, edhe pse kemi akte rregullatore të martuara më herët. Udhëzuesi i punës në mënyrën, si është hartuar,

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

është një ndihmë e vyer për KQV- në gjatë ditës së zgjedhjeve në mënyrë të posaçme. Sekretari i Përgjithshëm do të prezantojë projekaktin.

Z. Y. Merkaj: Faleminderit! Në referim të neneve 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42 dhe 43 të Kodit Zgjedhor, të cilat përcaktojnë detyrat e Komisionit të Qendrës së Votimit, përbërjen, papajtueshmërinë me detyrën e anëtarëve dhe sekretarit të Komisionit të Qendrës së Votimit shkarkimi dhe lirimi i anëtarëve të sekretarit të KQV-së si dhe detyrat e sekretarit të Komisionit të Qendrës së Votimit është përgatitur udhëzimi i punës së Komisionit të Qendrës së Votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Ky udhëzim është një material në ndihmë të Komisionit të Qendrës së Votimit për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore. Detyrat e KQV-së janë përcaktuar në Kodin Zgjedhor dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të këtij Kodi. Qëllimi i këtij materiali nuk është përsëritja e parashikimeve të Kodit, por është një udhëzues ku janë përmbledhur aspekte themelore të funksionimit të detyrave të Komisionit të Qendrës së Votimit. Ky udhëzues që iu vjen në ndihmë edhe trajnerëve të administratës zgjedhore për zhvillimin e trajnimeve si dhe Komisioneve të Qendrave të Votimit dhe për funksionimin e tyre, administrimin dhe zhvillimin e zgjedhjeve në Qendrën e Votimit. Në udhëzues janë parashikuar edhe detyrat funksionale të Komisionit të Qendrës së Votimit, por edhe një informacion shterues lidhur me dokumentacionin e punës së KQV-së, që Komisioni Qendror, përdor llojet e vendimeve apo procesverbaleve që Komisioni i Qendrës së Votimit plotëson. Udhëzuesi shpjegon detyrat dhe veprimet që kryen Komisioni i Qendrës së Votimit para ditës së zgjedhjeve, si edhe detyrat dhe veprimet që kryen në ditën e zgjedhjeve. Për një kuptueshmëri më të mirë të udhëzuesit dita e zgjedhjeve është ndarë në dy rubrika, në të cilat janë parashikuar veprimet e Komisionit të Qendrës së Votimit që kryhen para hapjes së votimit, procedurën e votimit, mbylljen e votimit si edhe veprime të tjera pas mbylljes së votimit. Udhëzuesi

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

ka parashikuar edhe procedurat që Komisioni i Qendrës së Votimit ndjek, lidhur me rastet kur pajisja e identifikimit elektronik nuk punon apo kur pajisja nuk regjistron gjurmën e shenjës së gishtave të zgjedhësve. Në udhëzues në pjesën e tetë, “Rregullat për qendrën e votimit” është trajtuar edhe personat që lejohen në qendrën e votimit, identifikimi i tyre si edhe hapësira që zë media e akredituar në një qendër votimi. Në udhëzues janë parashikuar edhe rastet e veçanta të votimit kur për të cilat përcaktohet se si vepron Komisioni i Qendrës së Votimit në rastet kur paraqitet një zgjedhës ku për arsye fizike nuk është në gjendje të kryejë vetë procedurat e votimit, ose kur në qendrën e votimit paraqitet një zgjedhës që nuk shikon. Udhëzuesi ka parashikuar edhe rastet kur cenojnë procesin zgjedhor, si për shembull rastet e votimit të dytë, apo paraqitja e një zgjedhësi i paregjistruar në listën e zgjedhësve, si dhe rastet kur zgjedhësi voton jashtë dhomës së fshehtësisë apo dëmton fletën e votimit pa dashje apo fotografon fletën e votimit. Të gjitha këto i kemi parashikuar tek udhëzimi i punës i Komisionit të Qendrës së Votimit, i cili i paraqet Komisionit Rregullator për shqyrtim dhe miratim.

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Merkajt! Fillojmë shqyrtimin në parim. A keni diçka kolegë për projektvendimin në parim? Jo. Votojmë në parim projektvendimin “Për miratimin e udhëzuesit të punës për Komisionet e Qendrave të Votimit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S’ka

Me 5 vota pro miratohet.

Vazhdojmë nen për nen apo pikë për pikë. Pra, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi: 1. Të miratojë

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

udhëzuesin e punës për Komisionet e Qendrave të Votimit për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Në fakt, thelbi i projektvendimit është pikërisht teksti i udhëzuesit. Duke qenë se edhe ky është një material voluminoz, që është shpërndarë, është publik, nuk mund të lexohet tashmë. Unë do të lexoj vetëm rubrikat kryesore të udhëzuesit. Kreu i parë janë rregullat e etikës; kreu i dytë përbërja e KQV-së me disa nënkrerë, që trajtojnë: vakancat në KQV, lirimin nga detyra, dorëheqjen, shkarkimin; kreu tre detyrat e komisionit të Qendrës së Votimit; kreu i katërt mbledhjet dhe vendimet e KQV-së; kreu i pestë dokumentacioni i KQV-së dhe vulat; kreu i gjashtë veprimtaria e KQV-së një ditë para zgjedhjeve, me nënkreun marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore dhe dokumenteve e tjera; kreu u shtatë veprimtaria e KQV-së në ditën e votimit; kreu i tetë rregullat në qendrën e votimit; kreu i nëntë raste të veçanta votimi; kreu i dhjetë veprimet që cenojnë procesin e votimit; kreu i njëmbëdhjetë skema orientuese e Komisionit të Qendrës së Votimit, ku është përfshirë skema, që sapo miratuar me vendimin e mëparshëm. Kolegë, a keni diçka për pikën 1?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

11-ta është skema orientuese. Shembujt janë te kreu i dymbëdhjetë, që janë hartuar në ndihmë të anëtarëve të KQV-së për të pasur shembuj të plotësimit të modeleve të vendimeve dhe procesverbaleve të cilat janë plotësuar të themi me emra fiktiv, që nuk i përkasin zgjedhësve të caktuar por vetëm për të krijuar një ide për mënyrën si duhet të plotësohen procesverbalet dhe kategoritë e vendimeve që merren nga KQV-ja.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Pika 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohen në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Me 5 vota pro miratohet.

(Diskutime pa mikrofon)

Shiheni mënyrën se si duhet ta shprehni, duke qenë që është udhëzues për KQV-në, administrata zgjedhore, sepse implikon edhe KZAZ-në një ditë para, te marrja në dorëzim e materialeve, edhe KQV-në. Atëherë, kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, kolegë.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka.

Me 5 vota pro miratohet.

Vendimi nr. 22

**Data 20.04.2023
Ora 15:46**

JASHTË RENDIT TË DITËS

PJESËMARRJA :

KQZ:

• Komisioni Rregullator:

- Ilirjana NANO Kryetar**
- Arens ÇELA Anëtar**
- Dritan ÇAKA Anëtar**
- Helga VUKAJ Anëtar**
- Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- Stafi KQZ Y. Merkaj, V.Ballgjini, E. Metaj, A.Tahiraj**
- Parti Politike: PDIU, PL**
- OJQ: KRIIK**

Znj. I Nano: Në fillim të mbledhjes e kanë kërkuar fjalën për çështje jashtë rendit të ditës zonja Vukaj dhe zoti Çakaj. Zonja Vukaj.

Znj. H. Vukaj: Po, faleminderit! Çështja e parë që dua të ngre, ose më saktë adresimin ndaj administratës, është ku gjendemi sot në lidhje me informacionin e kërkuar prej shumë javësh nga organet e ndryshme ligjzbatuese, apo që administrojnë të dhëna në lidhje me atë që ne kemi detyrë dhe përgjegjësi, moslejimin e subjekteve zgjedhore apo partive, apo institucioneve të kryejnë veprimtari të ndaluara apo të përfshihen në cenimin e garës së barabartë? Kështu që unë jam gjithë sy e veshë, zoti sekretar i Përgjithshëm, të di se ku jemi në kushtet e kërkesave të drejtuara herë pas herë me shqetësim nga ana ime. Përpos

***Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ***

 1

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

kësaj, edhe në lidhje me organin e prokurorisë, në të gjitha njësitë vendore, në qoftë se ka sjellë informacion se ku është në procedimin në lidhje me veprat penale të klasifikuara ose të paramenduara, ose të prezumuara si krime zgjedhore e më pas nëse kemi informacion për raste ju apo ata kanë nisur kryesisht. Së dyti, pastaj kam edhe një çështje tjetër, të cilën do ta diskutoj pas marrjes së informacionit.

Z. Y. Merkaj: E nderuar anëtare e Komisionit Rregullator, informacioni që kërkonit është shumë i gjerë dhe unë jam i papërgatitur për momentin. Do të kërkoja që të kërkonit ju një mbledhje tjetër, që të përgatiteshim. Kemi një faqe të KQZ-së, që është për denoncimet, kemi disa monitorues, 120 monitorues në gjithë Shqipërinë, kështu që informacioni është shumë i gjerë dhe mua më duhet ta përgatis, ta përthith dhe pastaj t’jua jap juve.

Znj. I. Nano: Mbledhja e ardhshme e Komisionit Rregullator llogaritet të jetë ditën e hënë, nëse është e mundur nga ana juaj.

Z. Y. Merkaj: Do përpiqemi.

Znj. H. Vukaj: Jo, unë me atë kuptoj që informacioni i gjerë presupozon faktin që kanë ardhur herë pas herë informacione nga këto institucione si, për shembull, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore Shëndetësore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Prokuroria apo SPAK-u dhe kanë sjellë një informacion kaq të bollshëm saqë ju ende s’e keni përpunuar, apo s’na keni njoftuar në kohë, që shikoni se ka ardhur informacioni?

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

Z. Y. Merkaj: Jo vetëm këto, po për të gjitha edhe për denoncimet, edhe për informacionet që kanë sjellë monitoruesi të shikojmë se si...

Znj. H. Vukaj: Po mirë pra, kur do të na informonit, në momentin kur zgjedhjet të bëhen reale dhe efekti të jetë dhënë?

Z. Y. Merkaj: Në mbledhjen e ardhshme do t'ju informojmë, do të kemi të bollshëm të gjithë materialin.

Znj. I. Nano: Në mbledhjen e ardhshme do të jetë çështje e rendit të ditës kjo, zoti sekretar i Përgjithshëm.

Znj. H. Vukaj: Së dyti, duke qenë që aktet tona kërkojnë një punë paraprake, ato janë voluminoze, siç e dini, apo komplekse dhe pa dyshim që duhet t'u referohemi dhe akteve të mëparshme përveç Kodit Zgjedhor, se çfarë është miratuar më herët nga ne, apo çfarë kanë shprehur institucionet, organet e tjera paralele me ne. Më lind shqetësimi që nuk ka një transparencë të mjaftueshme dhe nuk ka eficiencë në lidhje me punën e organeve të tjera zgjedhore, për këto zgjedhje në këtë rast, të cilat si bazë ligjore ose si referencë për të ushtruar veprimtari në mënyrë korrekte, nuk kanë vetëm aktet e çuara nga ne fizikisht, apo urdhërimet tona, por njëkohësisht një nga mënyrat dhe mjetet është faqja jonë, e cila ende ka akte të paazhornuara dhe akte të painkorporuara me ndryshimet apo shtesat përkatëse. Kjo e bën të ceduar procesin, në rast se do t'u referoheshim akteve që janë sot aktualisht në faqe, ndaj unë kërkoj me këmbëngulje që aktet menjëherë të fillojnë të azhurnohen dhe të hidhen të azhurnuara që nga dita e parë e veprimtarisë së kësaj formature të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve e deri tani, duke i plotësuar aktet, aktet bazë me ndryshimet dhe shtesat përkatëse. Kjo do ta bënte transparente vendimmarrjen, njëkohësisht do të ndihmonte vendimmarrjen e të

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

P. Ruzh 3

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*


gjithë komisioneve, të cilat janë në funksion të një procesi të drejtë dhe të bazuar. Edhe për këtë, të lutem, dua një informacion ose një konfirmim sesi e keni vënë në zbatim, apo në ç'fazë do të jeni herën e ardhshme.

Z. Y. Merkaj: Patjetër.

Znj. I. Nano: Po, zoti Merkaj, në fakt, besoj se është një shqetësim i të gjithë anëtarëve të Komisionit Rregullator ky që sapo trajtoi zonja Vukaj, për të patur akte të integruara, pra, aktet bazë me gjithë ndryshimet, në mënyrë që edhe kur organet e tjera, sikundër zonja Vukaj e tha, t'i referohen, t'i duhen për të punuar, kur jemi ne që ndodhemi në vështirësi jo më të tjerë që i marrin, dhe nuk janë të shumta. Pra ato akte që janë ndryshuar, po ka nga ato, që janë ndryshuar 2 apo 3 herë, kanë pësuar shtesa apo ndryshime, të cilat do të duhen të përktheheshin në formate të integruara të akteve. Zoti Çakaj kishte diçka jashtë rendit të ditës.

Z. M. Çakaj: Po, faleminderit e nderuar! Atëherë siç jemi të gjithë në dijëni, me dekretin nr. 13/864 të Presidentit të Republikës, të datës 24 tetor është dekretuar data 14 maj 2023 për zhvillimin e zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore. Në vijim partitë politike të interesuara për të marrë pjesë në zgjedhje, brenda afateve ligjore, janë regjistruar si subjekte zgjedhore pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përsëri brenda afateve ligjore kanë paraqitur listat me kandidatët si për këshilltarë bashkiakë, ashtu edhe për kandidatët për kryetar bashkie. Me sa kemi të gjithë informacion, se është edhe zyrtar tashmë, për Bashkinë e Tiranës kandidon për subjektin Partia Socialiste, Erjon Veliaj, mos gaboj, ndërkohë rrugës duke ardhur këtu, po besoj e kemi konstatuar të gjithë, rezulton që janë mbushur të gjithë rrugët e Tiranës me *billboardera* dhe *postera* të ndara në gjysmë, ku në gjysmën sipër figuron Kryeministri i vendit, Edi Rama, dhe në gjysmën poshtë figurojnë 2 liderët e opozitës: Ilir Meta dhe Sali Berisha.

*Zbardhi materialin audio
Mirgjina LEKAJ*

 4

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

Sigurisht që kjo foto është me përmbajtje denigruese, pra synon të përcjellë mesazh denigrues për opozitën dhe liderët e opozitës në veçanti dhe synon të përcjellë mesazh pozitiv për Kryeministrin Edi Rama. Tani pyetja që shtroj unë, së pari, në raport me Kodin Zgjedhor, me nenin 79 të Kodit Zgjedhor: “Afishimi i materialeve propagandistike”, në nenin 79, në pikën 2 parashikohet që gjatë fushatës zgjedhore përdorimi dhe afishimi i çdo materiali tjetër statik për propagandë zgjedhore, përfshirë flamujt dhe posterat, lejohet vetëm në një largësi prej deri 5 metra nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës. Zoti sekretar i Përgjithshëm, a kemi të bëjmë me një shkelje të nenit 79, pika 2 të Kodit Zgjedhor? A kemi ndonjë denoncim, a kemi ndonjë raportim nga monitoruesit tuaj për këtë që sapo deklarova? Në dijeninë time dhe në dijeninë e të gjithëve neve për Bashkinë e Tiranës kandidon Erion Veliaj dhe jo Edi Rama, apo jo? Është pyetje zoti sekretar, mund të përgjigjeni?

Z. Y. Merkaç: Po mund t’i përgjigjem pyetjes së dytë. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve nuk ka asnjë informacion ose ndonjë denoncim për këtë. Nuk ka denoncim ...

Z. M. Çakaj: As për këtë nuk ka asnjë denoncim? Po kryesisht? Në senatin tonë kemi..

Z. Y. Merkaç: Kryesisht KQZ-ja edhe mund të veprojë, megjithatë...

Z. M. Çakaj: Po ne nuk jemi një institucion shurdh, o zoti sekretar i Përgjithshëm! Nuk jemi as në funksion të një partie politike, qoftë e mazhoransës apo opozitës qoftë kjo, ne jemi një institucion që mundohemi të miratojmë disa rregulla dhe parime, të cilat synojnë që palët të kenë kushte të barabarta për të garuar. Sigurisht

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.20.04.2023*

që rezultati të jetë sa më afër të drejtës, se nuk po pretendojmë kushte ideale për garë.

Z. Y. Merkaj: Në dijeninë time nuk ka ardhur denoncim.

Z. M. Çakaj: Po jemi kthyer në një institucion shurdh, jemi kthyer në një institucion shurdh dhe qorr. Atëherë nuk ngelet gjë tjetër veçse t'i fshijmë edhe Kodin Zgjedhor apo aktet nënligjore, të cilat ne i miratojmë, sepse për sa kohë janë vetëm në letër, po nuk gjejmë zbatim praktik, çfarë kuptimi ka kjo!

Z. Y. Merkaj: Sa u informuam nga drejtoresha se sot është bërë një denoncim nga monitoruesi i Tiranës, nga njësia 7, që qenka kjo tabelë, sot ka ardhur. Tregon që sot qenka vendos tabela.

Z. M. Çakaj: Jo, nuk janë vendosur sot tabelat, jo të lutem, të lutem tabelat kanë disa ditë që janë vendosur, megjithatë shqetësimi im nuk është për përmbajtjen e tabelës, sigurisht që e ka tagër Komisioneri dhe më pas Komisioni i Sanksioneve edhe Ankesave ta gjykojë dhe, sigurisht, nëse palët kanë probleme të tjera për sanksion mund të shkojnë edhe në Gjykatën Administrative apo sipas rastit të Kodit Zgjedhor. Çështja që unë shtroj këtu është a përbën shkelje të nenit 79, pika 2 të Kodit Zgjedhor, apo të gjithë rrugët e Tiranës janë zyra të një partie elektorale, se nuk më rezulton kështu jo për gjë?

Z. Y. Merkaj: Këtë pyetje ma bën si sekretar i Përgjithshëm, apo ma bëni si...

Z. M. Çakaj: Unë po ta bëj këtë pyetje si zyrtari më i lartë i Komisioni Qendror të Zgjedhjeve.

Z. Y. Merkaj: Këtë përgjigje s'mund ta jap dot, do të bëhet me vendimmarrje të Komisionerit, s'mund të jap dot, do të bëhet me vendimmarrje të Komisionerit.

Z. M. Çakaj: Do të përgatiteni edhe për këtë pyetje?

Z. Y. Merkaj: Jo, do të bëhet me vendimmarrje të Komisionierit.

Z. M. Çakaj: Mirë, dakord, të lutem, në mbledhjen e radhës dua një raport të hollësishëm për këto çështje që shtrova. Faleminderit, s'kisha gjë tjetër!

Znj. I. Nano: Faleminderit, zoti Çakaj! Atëherë, zoti Merkaj, nga kolegët është kërkuar informacion dhe raportim për çështjet që janë ngritur dhe siç ju thashë parashikohet ndoshta të hënën të kemi një mbledhje të radhës të Komisionit Rregullator. Të lutem, të keni informacionin, do ta kemi pikë të rendit të ditës, tek të tjerat, do të kemi pikërisht këto çështje. Atëherë nëse nuk kemi diçka tjetër projektaktet i miratuam, çështjet jashtë rendit të ditës u trajtuan, atëherë mbledhjen e deklaroj të mbyllur. Faleminderit!